

Vendim nr. 158, datë 20.05.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Marjana Semini,	Anëtare
Asim Vokshi,	Anëtar

në datën 20.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (F) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **FATMIRA KOLA, person fizik**, përfaqësuar nga avokati Altin Kaziaj.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 4573, datë 24.03.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; nr. 1269/30-2025-4116, datë 19.05.2025 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2025-1588, datë 16.10.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, pika 1, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Asim Vokshi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi Y.S., administratori i shoqërisë “Çelësi” sh.p.k., ka bërë një denoncim në Drejtorinë e Hetimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe më pas kallëzim penal, duke pretenduar se platforma *online* me emrin “njoftimefalas.com” me URL “www.njoftimefalas.com”, e paregjistruar dhe e palicencuar, përdor për cilësimin dhe identifikimin e të gjitha kategorive të nënfaqeve të saj togfjalëshin “gazeta çelësi”, duke tërhequr drejt vetes klientët që kërkojnë në internet me këtë togfjalësh, duke realizuar në këtë mënyrë konkurrencë të pandershme nëpërmjet mashtrimit të klientëve të kësaj gazete, si dhe duke i krijuar kësaj të fundit një dëm të konsiderueshëm financiar. Çështja është regjistruar nga prokuroria në vitin 2018 dhe në fund të vitit 2021 është dërguar në gjykatë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1730, datë 25.06.2024, ka deklaruar fajtorë shtetasit E.S. dhe A.K. (vëllai i kërkueses) për kryerjen e veprave penale të mashtrimit kompjuterik, të kryer në bashkëpunim dhe fshehjes të të ardhurave, të kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 143/b/2, 180/1 dhe 25 të Kodit Penal (KP) dhe ka dënuar secilin me 5 vjet burgim, duke i hequr edhe të drejtën për ushtrimin e veprimtarive drejtuese pranë personave juridikë për 5 vjet. Ndaj këtij vendimi kanë ushtruar ankim të pandehurit. Në datën 28.06.2024, tre ditë pas vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të cilin është dënuar vëllai i kërkueses, kjo e fundit është regjistruar në regjistrin tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) si person fizik me emër tregtar “njoftime.al” dhe objekt aktiviteti “*Publikimi i njoftimeve online për biznese dhe individë. Marketimi dhe ndërmjetësimi në fushën e punësimit [...]*”.

2. Ndërkohë, edhe pas përfundimit të hetimeve dhe dërgimit të çështjes në gjykatë, aktiviteti i faqes “www.njoftimefalas.com” ka vijuar pa ndërprerje. Në këto kushte, si dhe pas sinjalizimeve të klientëve se janë kërcënuar në rast të një bashkëpunimi të ri me gazetën çelësi, administratori i shoqërisë së dëmtuar ka paraqitur sërish denoncim në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, e cila, pasi ka konstatuar se faqja në fjalë ushtronte aktivitet të paregjistruar në tatime, i ka kërkuar Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) të bllokonte aktivitetin e saj në internet. Pas ekzekutimit të vendimit të AKEP-it për bllokimin në Shqipëri të kësaj faqeje interneti dhe llogarive të saj në rrjete sociale, klientëve u janë shpërndarë njoftime sesi mund ta aksesonin faqen nëpërmjet përdorimit të aplikacioneve që fshihnin identifikimin e aksesit nga Shqipëria. Ndonëse ishte duke u zhvilluar një çështje penale në gjykatë, administratori i shoqërisë së dëmtuar ka bërë sërish kallëzim penal referuar provave të reja pas mbylljes së hetimeve dhe dëmit financiar që vijonte. Mbi bazën e këtij materiali kallëzues, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (*Prokuroria e Tiranës*) ka regjistruar

procedimin penal nr. 1800/2023 për veprat penale “Mashtrimi kompjuterik”, “Fshehja e të ardhurave” dhe “Punësimi i paligjshëm”, të parashikuara nga nenet 143/b, 180 dhe 170/a të KP-së.

3. Gjatë hetimeve është këqyruar faqja “www.njoftimefalas.com” dhe llogaritë e saj në rrjetet sociale, nga kanë rezultuar të njëjtat të dhëna kontakti dhe i njëjti njoftim për bllokim nga AKEP-i; janë administruar akte noteriale të klientëve dhe prova të tjera për pagesa të kryera në llogarinë *Paypal* për faqen “www.njoftimefalas.com”, për të cilat nuk është lëshuar faturë; është kryer një ekspertim kompjuterik nga i cili është konkluduar se faqet “www.njoftimefalas.com” (e zotëruar nga shtetasit E.S. dhe A.K.) dhe “www.njoftime.al” (e zotëruar nga kërkuesja), janë të njëjta nga ana teknike, me ndryshime të vogla sipërfaqësore në anën vizuale, se të dyja faqet kanë përmbajtje të njëjta, ID të njëjtë të njoftimeve, gabime ortografike të njëjta dhe simbole të njëjta të përdorura në njoftimet e publikuara. Në vijim, Prokuroria e Tiranës ka paraqitur në gjykatë kërkesë për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, faqes (*domain*) “www.njoftime.al”.

4. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 4537, datë 24.03.2025, ka vendosur pranimin e kërkesës bazuar në nenin 208/a të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*) dhe sekuestrimin e faqes (*domain*) “www.njoftime.al”. Sipas asaj gjykate, pas procesit të parë gjyqësor, shtetasi E.S. ka marrë një *domain* në Shqipëri me emrin “www.njoftime.al”, të cilin e ka hapur në momentin e dërgimit të çështjes në gjykatë. Kjo faqe, sipas saj, ka të njëjtin informacion dhe përdor të njëjtën platformë si faqja “www.njoftimefalas.com” dhe i shërben për të fshehur gjurmët dhe për të zbardhur aktivitetin e paligjshëm të kësaj të fundit, duke trashëguar të gjithë klientët dhe pozicionin konkurrues në treg të arritur nga ajo (njoftimefalas.com) në mënyrë të paligjshme.

5. Vendimi i mësipërm është miratuar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm me vendimin nr. 1269/30-2025-4116, datë 19.05.2025. Ajo gjykatë ka evidentuar se tri ditë pas vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka dënuar shtetasin E.S. dhe vëllain e kërkueses për kryerjen e veprave penale të mashtrimit kompjuterik, si dhe fshehjes të të ardhurave, duke e lidhur me veprimtarinë e paligjshme të faqes “www.njoftimefalas.com”, kërkuesja është regjistruar në QKB për ushtrimin e aktivitetit tregtar për një faqe interneti me *domain* “.al”. Po kështu, ajo gjykatë ka evidentuar se nga ekspertimi kompjuterik, i kryer në kuadër të procedimit penal, ka rezultuar se faqet “www.njoftimefalas.com” dhe “www.njoftime.al”, janë të njëjta nga ana teknike, me ndryshime të vogla sipërfaqësore në anën vizuale (ato kanë përmbajtje të njëjta, ID të njëjtë të njoftimeve, gabime ortografike të njëjta dhe simbole të njëjta të përdorura në njoftimet e publikuara), arsye për të cilën Prokuroria e Tiranës ka kërkuar në gjykatë sekuestrimin e *domain*-

it shqiptar (.al). Në vijim, ajo gjykatë ka arsyetuar se në rastin konkret, përveç instrumentit ligjor të sekuestros të të dhënave kompjuterike, nuk rezulton të ekzistojë asnjë mundësi tjetër (shteg tjetër procedural) që të provojë ekzistencën e veprave penale për të cilat është regjistruar procedimi penal nr. 1800/2023. Sipas saj, në analizë të rrethanave të çështjes, ka rezultuar e provuar se sendi objekt kërkesë për vendosje sekuestroje provuese (të dhënat kompjuterike) shërben si provë në vërtetimin e faktit penal dhe se organi procedues ka sjellë prova të mjaftueshme që vërtetojnë lidhjen e objektit të sekuestros provuese me dyshimin e arsyeshëm për kryerjen e një veprave penale në fushën e teknologjisë së informacionit, pra që të dhënat e sekuestruara do të kenë rëndësi themelore për hetimin e çështjes dhe se nuk ka mënyrë tjetër për të mbërritur në vërtetimin e faktit penal. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuësja.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1588, datë 16.10.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuësës, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Ajo gjykatë ka vlerësuar se pretendimet e kërkuësës kanë marrë përgjigje nga gjykata e apelit me një arsyetim të mjaftueshëm të vendimmarrjes së saj, e cila nuk është kontradiktore. Sipas Gjykatës së Lartë, në çështjen konkrete nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, apo me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, dhe se vendimi i ankimuar nuk bie në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Përkundrazi, ajo gjykatë ka vlerësuar se vendimet e gjykatave më të ulëta janë rrjedhojë e zbatimit të drejtë të vendimit të saj njësues nr. 00-2021-1135 (147), datë 23.12.2021, si dhe nenit 208 të KPP-së.

7. Në datën 20.02.2026 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuësës

8. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar:

8.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me *standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi:

8.1.1. Gjykatat e faktit kanë parashtruar arsytetime standarde dhe stereotipe, të pabazuara në një analizë konkrete të provave që Prokuroria e Tiranës prezumon se disponon për vendosjen e sekuestros. Vendimet e atyre gjykatave kanë pamjaftueshmëri arsyetimi,

pasi nuk argumentojnë: i) se ekziston dyshimi i arsyeshëm i mbështetur në prova se pasuria objekt sekuestroje mund të jetë produkt i veprimtarisë kriminale të personit nën hetim; ii) lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të kërkueses; iii) për ndonjë indicie ose të dhënë sipas së cilës do të mund të verifikohet probabiliteti i veprimeve për tjetërsimin e pasurive objekt sekuestroje; iv) lidhja e drejtpërdrejtë e sendit të sekuestruar me veprën penale (*domain-it* “.com” dhe *domain-it* shqiptar “.al” që i përket ankueses, e cila nuk është thirrur për t’u pyetur ose për të dhënë shpjegime mbi prezumimet e prokurorisë).

8.1.2.Rekursi i kërkueses nuk ka qenë haptazi i pabazuar, ndaj Kolegji Penal duhet ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

8.1.3.Vendimi i Gjykatës së Lartë është i gabuar dhe ka mospërputhje mes arsytimit dhe shkaqeve të paraqitura në rekurs, duke u mjaftuar ajo gjykatë me faktin se pretendimet e ngritura në rekurs kanë marrë përgjigje nga gjykata e apelit, pa u dhënë përgjigje pretendimeve se nga gjykatat e faktit nuk janë respektuar parimet e proporcionalitetit dhe të përshtatshmërisë; se gjykata e apelit, në zbatim të parimeve të proporcionalitetit dhe të përshtatshmërisë në kuptimin kohor të sekuestrës duhet të verifikonte e të shqyrtonte nëse mbajtja nën sekuestro e sendit është e nevojshme dhe nëse Prokuroria e Tiranës mund të zbatonte nenin 208/a, paragrafi 3, shkronja “b”, të KPP-së (duke nxjerrë dhe marrë kopje të të dhënave kompjuterike) dhe paragrafit të parë të nenit 213 të po këtij kodi (duke marrë kopje të akteve dhe të dokumenteve); se gjykatat e faktit kanë cenuar parimin e sigurisë juridike për shkak të marrjes dhe legjitimitetit të masës së sekuestrës mbi një kallëzim të bërë nga një person i tretë për një faqe *online* që nuk ka asnjë lidhje me faqen e sekuestruar dhe me personat që zotërojnë këto faqe.

8.1.4.Ky vendim bie ndesh me qëndrimet e mbajtura nga vetë ajo gjykatë në vendimin njësuës nr. 00-2021-1135 (147), datë 23.12.2021, për zbatimin e neneve 208, 208/a dhe 212 të KPP-së, ku është theksuar se parimet e domosdoshmërisë dhe të përshtatshmërisë e të proporcionalitetit duhet të udhëheqin vendimmarrjen e gjykatës, qoftë në marrjen e vendimit për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, qoftë edhe në lidhje me parashikimin e modaliteteve konkrete për sekuestrimin e këtyre të dhënave. Gjithashtu, ajo gjykatë nuk ka referuar standardet ndërkombëtare dhe as jurisprudencën e kësaj Gjykate.

8.2. *Liria e veprimtarisë ekonomike dhe konkurrenca e ndershme*, të parashikuara nga nenet 11 dhe 49 të Kushtetutës, për shkak të të gjithë procedurës së ndjekur nga Prokuroria Tiranë dhe gjykatat, duke qenë se vetë kallëzuesi është biznes konkurrent dhe mund të përfitojë nga vendosja e kësaj sekuestroje.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Kërkuësja, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi. Po kështu, ajo plotëson edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e në substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kërkuësja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 16.10.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 20.02.2026, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

11. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuësja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor (në aspektet e *së drejtës së aksesit në gjykatë* dhe të *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*), si dhe të *lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe të konkurrencës*

së ndershme, që prima facie përfshihen në juridiksionin kushtetues. Për sa i takon pretendimit për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe të konkurrencës së ndershme, nisur nga thelbi dhe përmbajtja e këtij pretendimi, si dhe në konsideratë të faktit se neni 42 i Kushtetutës parashikon se liria dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë, Kolegji çmon që, në rastin konkret, ky pretendim i kërkuësës të analizohet në themel në drejtim të së drejtës për proces të rregull ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

12. Kërkuësja ka pretenduar se gjykatat e faktit nuk kanë arsyetuar mjaftueshëm për vendosjen e sekuestros, në rastin konkret, ndërsa Gjykata e Lartë me anë të një vendimi për mospranimin e rekursit nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të saj që lidheshin kryesisht me mosrespektimin nga gjykatat më të ulëta të parimeve të proporcionalitetit dhe të përshtatshmërisë në vendosjen e masës së sekuestros. Prandaj, vendimi i Gjykatës së Lartë është i gabuar dhe ka mospërputhje mes pjesës së arsytimit dhe shkaqeve të paraqitura në rekurs, të cilat kishin natyrë kushtetuese. Ai vendim bie ndesh edhe me kriteret e përcaktuara nga vetë ajo në vendimin njësuës si në lidhje me lejimin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike, ashtu edhe për parashikimin e modaliteteve konkrete për sekuestrimin e këtyre të dhënave. Duke qenë se shkaqet e rekursit nuk ishin haptazi të pabazuara, ajo gjykatë duhej ta shqyrtonte çështjen në seancë me praninë e palëve.

13. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirisë dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Ndërkohë, neni 142, pika 1, i Kushtetutës parashikon se vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.

14. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 6, datë 22.02.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në lidhje me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i drejtësisë së vendimeve. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Gjykata ka pohuar se standardi i arsytimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është edhe e drejta e aksesit në gjykim. Megjithatë, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 45, datë 03.07.2017; nr.12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Për sa i takon vendimit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, në jurisprudencë konstante të Gjykatës është pranuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimin të rekursit nga ana e kolegjeve të Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 67, datë 03.10.2024; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata është shprehur se në vlerësimin e shkaqeve ligjore të rekursit dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore, nëse kolegjii i Gjykatës së Lartë krijon bindjen se ato janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore, ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, vendos mospranimin e tij (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata në vijimësi është shprehur se ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që e bën gjykimin të padrejtë (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Referuar standardeve të mësipërme kushtetuese, si dhe duke pasur parasysh natyrën dhe thelbin e pretendimeve të kërkuases, Kolegjii do të analizojë në vijim nëse arsyetimi i vendimeve gjyqësore të kundërshtuara është mjaftueshëm dhe i qartë në përmbajtje dhe nëse argumentet e pjesës arsyetuese janë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese të tyre, si dhe nëse interpretimi i ligjit nga gjykatat ka qenë ose jo arbitrar në

këndvështrimin kushtetues, duke sjellë, si pasojë, për kërkuesen cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë.

18. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vëren se në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është duke u zhvilluar një proces penal me të pandehur vëllain e kërkueses dhe një shtetas tjetër, të cilët akuzohen se në bashkëpunim kanë kryer veprat penale të mashtrimit kompjuterik dhe fshehjes të të ardhurave nëpërmjet përdorimit të një faqeje interneti (www.njoftimefalas.com) të paregjistruar dhe të palicencuar, e cila ka krijuar të ardhura të konsiderueshme duke mashtruar klientët e një subjekti tjetër tregtar. Po kështu, Kolegji vëren se tri ditë pas vendimit të gjykatës së shkallës së parë për dënimin e vëllait të kërkueses, kjo e fundit ka regjistruar një aktivitet në QKB që lidhet me një faqe interneti (njoftime.al). Nga procesi i dytë penal, në vijimësi të të parit, ka rezultuar se faqja e internetit e zotëruar nga kërkuesja është e njëjtë nga ana teknike, me ndryshime të vogla në anën vizuale, me faqen e zotëruar nga vëllai i saj dhe shtetasi tjetër, për rrjedhojë Prokuroria e Tiranës ka kërkuar sekuestrim edhe të faqes me *domain-in* shqiptar (.al).

19. Gjykata e shkallës së parë, që ka pranuar kërkesën për sekuestrimin e faqes në zotërim të kërkueses, ka arsyetuar se pas procesit të parë gjyqësor shtetasi E.S. ka marrë një *domain-in* në Shqipëri (njoftime.al) të cilin e ka hapur në momentin e dërgimit të çështjes në gjykatë, që ka të njëjtin informacion dhe përdor të njëjtën platformë me “njoftimefalas.com”, me qëllim për të fshehur gjurmët dhe për të zbardhur aktivitetin e paligjshëm të kësaj të fundit, duke trashëguar të gjithë klientët dhe pozicionin konkurrues të arritur nga ajo në mënyrë të jashtëligjshme (*shih faqet 3-4 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë*). Gjykata e apelit e ka miratuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, pasi shkaqet e ankimit i ka gjetur të pambështetura në ligj e në prova. Në përgjigje të pretendimit për proporcionalitetin dhe përshtatshmërinë e masës, gjykata e apelit ka arsyetuar se, në rastin konkret, përveç instrumentit ligjor të sekuestros të të dhënave kompjuterike nuk rezulton të ekzistojë asnjë mundësi tjetër (shteg tjetër procedural) që të provojë ekzistencën e veprave penale për të cilat është regjistruar procedimi penal nr. 1800/2023. Sipas saj, në analizë të rrethanave të çështjes ka rezultuar e provuar se sendi objekt kërkese për vendosje sekuestroje provuese (të dhënat kompjuterike) shërben si provë në vërtetimin e faktit penal dhe se organi procedues ka sjellë prova të mjaftueshme që vërtetojnë lidhjen e objektit të sekuestros provuese me dyshimin e arsyeshem për kryerjen e një veprë penale në fushën e teknologjisë së informacionit, pra që të dhënat e sekuestruara do të kenë rëndësi themelore për hetimin e çështjes dhe se nuk ka mënyrë tjetër për të mbërritur në vërtetimin e faktit penal (*shih faqet 12 dhe 13 të vendimit të gjykatës së apelit*). Ky vendim është vlerësuar i drejtë, në thelb, nga Kolegji Penal i Gjykatës së

Lartë, i cili ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuases, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë prej shkaqeve të parashikuara në ligj, pasi ka vlerësuar se vendimet e gjykatave më të ulëta janë rrjedhojë e zbatimit të drejtë vendimit të saj njësuës nr. 00-2021-1135 (147), datë 23.12.2021 (*shih paragrafin nr. 30 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

20. Në këndvështrim të përmbajtjes së pretendimeve të kërkuases dhe në analizë të vendimeve gjyqësore objekt të ankimit kushtetues individual, Kolegji vëren se kërkuësja ka ushtruar lirisht të drejtën e ankimit në gjykatat më të larta. Gjykata e shkallës së parë që ka pranuar kërkesën e prokurorisë, e ka arsyetuar vendosjen e sekuestros për faqen e internetit që zotëron kërkuësja dhe lidhjen me veprën penale kryesore që po hetohet. Gjykata e apelit që ka miratuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ka dhënë përgjigje të arsyetuar për pretendimin për mungesën e proporcionalitetit dhe të përshtatshmërisë në vendosjen e masës së sekuestros. Ato vendime përmbajnë çështjet e faktit dhe të ligjit të vëna në diskutim, sikundër edhe argumentet për to. Ato vendime nuk duken të paqarta në përmbajtje dhe as që argumentet e parashtruara në pjesën arsyetuese të tyre të mos jenë të mjaftueshme për të mbështetur disponimin në pjesën urdhëruese të vendimit.

21. Ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuases, duke pranuar në thelb arsyetimin e gjykatës së apelit. Duke pasur parasysh natyrën e vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë, përmes të cilit, në kuadër të verifikimit të kriterëve të pranueshmërisë së rekursit të kërkuases, është vendosur mospranimi i tij, si dhe faktin se në të janë listuar shkaqet e parashtruara në rekurs, pavarësisht arsyetimit të kufizuar për to, Kolegji vlerëson se, në kundërshtim nga sa pretendon kërkuësja, arsyetimi i këtij vendimi nuk rezulton në cenim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, sipas jurisprudencës kushtetuese.

22. Nën këtë optikë, Kolegji vlerëson se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në vendimet e kundërshtuara përmes ankimit kushtetues individual, kanë përmbushur detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre, ndërkohë që interpretimi i ligjit nga ato, i shprehur përmes arsyetimit, nuk rezulton i paarsyeshëm në këndvështrimin kushtetues, në kuptimin që të bjerë ndesh me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës. Ato gjykata kanë marrë në shqyrtim, kanë analizuar dhe kanë vlerësuar në mënyrë të argumentuar pretendimet e kërkuases në ankim dhe në rekurs, në respektim të së drejtës së aksesit në gjykatë.

23. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuases për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

24. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprahe për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare, pasi është haptazi i pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.